

Projekti “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri”

THIRRJE PËR APLIKIM NR.2

për Institucionet Arsimore të sistemit të arsimit bazë dhe të mesëm të lartë që do të jenë pjesë e projektit
“Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri”
për vitin shkollor 2021-2022

1. Konteksti

Projekti “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri” zbatohet nga Këshilli i Evropës dhe financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida). Projekti do të zbatohet për një periudhë katër-vjeçare. Projekti synon të përmirësojë cilësinë e arsimit parauniversitar në Shqipëri, duke forcuar kapacitetet e sistemit arsimor që zhvillojnë kompetencat e nxënësve për kulturë demokratike, në përputhje me instrumentet dhe qasjet e Këshillit të Evropës.

Projekti synon të përkrahë reformën aktuale të kurrikulave shkollore, bazuar në *kompetenca* dhe qasjet e reja të arsimit që ato përfshijnë, si dhe metodat e mësimdhënies me në qendër nxënësin.

Projekti përgjatë tre viteve do të mbështesë 75 shkolla pilot të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë (ndarë në tre cikle, 25 shkolla të përzgjedhura për secilin vit), për të zhvilluar dhe zbatuar kulturën demokratike, politikat dhe praktikën për qeverisje demokratike në shkollë, me synimin për të krijuar një mjedis nxënës e gjithëpërfshirës dhe për të gjithë nxënësit. Secili nga tre ciklet do të zhvillohet gjatë një viti shkollor. **Thirrja aktuale synon përzgjedhjen e grupit të dytë të 25 shkollave pilot që do të jenë pjesë e projektit¹.** Shkollat e zgjedhura do të bashkohen në **Rrjetin e Shkollave Demokratike dhe Gjithëpërfshirëse** të krijuara nga projekti.

1 25 shkollat e para pilot që morën pjesë në zbatimin e projektit për vitin 2021 u zgjodhën përmes një procedure të hapur dhe konkurruese të shpallur në vitin 2020. Një Rrjet i Shkollave Demokratike dhe Gjithëpërfshirëse është krijuar në kuadër të projektit dhe shërben si një komunitet dhe platformë për shpërndarjen në të gjithë vendin të praktikave të mira shkollore.

Shkollat do të mbështeten nëpërmjet skemës së granteve të vogla për Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) për të zhvilluar dhe zbatuar projekte të propozuara dhe udhëhequra

nga vetë nëxësit në shkollat dhe komunitetet e tyre. Çdo vit, shkollave do t'u ofrohet një temë e ndryshme që lidhet me aftësitë, vlerat, qëndrimet dhe njohuritë e Kuadrit të Kompetencave për Kulturë Demokratike të Këshillit të Evropës.

Për vitin shkollor 2021-2022, tema e përzgjedhur është **“Mbrotjtja e mjedisit - pjesë thelbësore e kulturës demokratike”**.

Kujdesi për të ardhmen e planetit dhe mbrotjtja e mjedisit është një pjesë thelbësore e një kulture demokratike në shoqëritë e sotme. Është një kontribut i vërtetë drejt shoqërive më përfshirëse dhe më transparente dhe përparimit të mëtijshëm të demokracive moderne. Roli i arsimtarëve vështirë se mund të nënvlerësohet në këtë proces dhe Këshilli i Evropës është i gatshëm t'i mbështesë dhe udhëzojë ata në këtë proces me mjetet e burimet e tij ekzistuese, si dhe përmes zhvillimit të metodave të reja me qëllim që të fuqizojë brezat e rinj.

Nxënësit, mësuesit dhe stafi drejtues i shkollës do të kenë mundësinë të marrin pjesë në veprimtaritë e shkëmbimeve të përvojave (*peer learning*), aktivitetet ndërgjegjëse, shkollat verore dhe rrjetet e punës.

Përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë, do të dakordësojnë bashkërisht përzgjedhjen e 25 shkollave të raundit të dytë të projektit, duke mbajtur parasysh kriteret e përcaktuara të përzgjedhjes. (në linkun bashkëlidhur)

Shkollat e interesuara, për të qenë pjesë e projektit, duhet të plotësojnë **Formularin e Aplikimit** bashkëlidhur dhe të dërgojnë dokumentet e mëposhtme mbështetëse:

Krahas Formularit të Aplikimit, duhet të bashkëlidhen dhe dokumentet e mëposhtme:

1. Plani i Zhvillimit ose Plani i Veprimit të shkollës
2. Letër mbështetjeje nga Bordi i Shkollës, për pjesëmarrjen e shkollës në projekt

Formulari i aplikimit së bashku me dokumentacionin shoqëruar, duke përfshirë edhe dokumentet që dëshmojnë praktikën e mira në shkollë, duhet të dërgohen **brenda datës 31 korrik 2021**, në adresën e emailit education.tirana@coe.int.